



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

Me datë 20.10.2022, Mekanizmi parandalues nacional (MPN) realizoi një vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Qendrën e përkohshme transitore (QPT) Tabanovc, ndërsa me datë 28.10.2022 në Qendrën e përkohshme transitore Vinojug.

Qëllimi i këtyre vizitave, konform Protokollit fakultativ të Konventës kundër torturës dhe trajtimit tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues ose ndëshkues, është identifikimi i rreziqeve për parandalimin e torturës ose llojit tjetër të trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues, ose ndëshkues.

Gjatë vizitave në Qendrat transitore janë shqyrtuar:

- kushtet materiale në vendet e akomodimit dhe ndalimit,
- sjellja e zyrtarëve në Qendrat,
- të dhënat e personave të akomoduar/ndaluar në Qendrat,
- vende të tjera (dhoma pune dhe dhoma të tjera ndihmëse si kuzhina, tualetet, etj.).

Avokati i popullit si Mekanizëm parandalues nacional i kushton vëmendje të veçantë dhe monitoron vazhdimisht trajtimin e migrantëve në vendet ku akomodohen dhe mbahen.

Këta persona janë në një pozitë të veçantë vulnerabiliteti duke pasur parasysh se janë jashtë vendeve të tyre të origjinës, nuk janë të njohur me kontekstin juridik dhe as me gjuhën e vendit ku ndodhen. Shumica prej tyre kanë përjetuar përvoja të gjata dhe traumatike gjatë udhëtimeve, e disa prej tyre edhe në vendet e tyre të origjinës të cilat i kanë braktisur nga frika e persekutimit, shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut apo konfliktit.

Për dallim nga QPT Tabanovc, ku me përjashtime të caktuara, personat të cilët janë vendosur në Qendër kanë mundësi të largohen lirisht nga ajo, në QPT Vinojug vazhdon praktika që personat të mbahen pa u dhënë aktvendime individuale të veçanta ku do të ceken arsyet e vendosjes/ndalimit, kohëzgjatja e ndalimit, mundësia dhe afati për ankesë ndaj aktvendimit të tillë dhe aksesit pranë ndihmës juridike.

Pjesëtarëve të Ministrisë së punëve të brendshme që janë të pranishëm në Qendrat, në kryerjen e detyrave dhe obligimeve për sigurimin e daljeve nga Qendrat, sigurimin e rendit dhe qetësisë, mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të personave që janë të vendosur (sipas nevojës) dhe për patrullim, u janë dhënë për ndihmë ushtarë të Armatës.

Kujdesi primar mjekësor, si dhe kujdesi mjekësor në dy qendrat transitore sigurohet nga ana e përfaqësuesve të Kryqit të Kuq dhe Organizatës ndërkombëtare për migrime.

Në qendrat e përkohshme, gjithashtu, vazhdimisht janë prezentë edhe përfaqësues të Ministrisë së punës dhe politikës sociale, prej ku caktohen kujdestarë për fëmijët e pashoqëruar.

Të pranishëm janë edhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare vendore, të cilët personave të ndalur u ofrojnë qasje në shërbimet nga fushëveprimi i tyre (informacione juridike, mbështetje psiko-sociale, arsim joformal, etj.), me dallimin se në QPT Tabanovc kjo prani është më pak e dukshme.

Pas vizitave të realizuara, Mekanizmi parandalues nacional do të përgatisë raporte të veçanta në të cilat do të konstatojë situatat pozitive dhe negative dhe do t'u japë rekomandime përkatëse organeve relevante me qëllim të eliminimit të mangësive.